

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“OUTLET STORE “ SHPK

Sot me date 07.11.2021, une ortak i vetem themelues,

zj. **CINZIA MUSU**, lindur me 09.05.1978, ne Oristano (OR), Itali dhe banues ne Itali, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin **Nr.323187** dhe numer personal **CA13513CO**,

me cilesine e ortakut themelues, deklaroj se me vullnet të lire e të plote dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare “, ne ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne Ligjin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, “ **OUTLET STORE “ SHPK**

KREU 1

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “**OUTLET STORE “ SHPK**, është person juridik i të drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria “**OUTLET STORE “ SHPK**, është nje shoqeri, që themelohet nga nje ortak i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Selia e Shoqerise eshte ne Rruga “ Kole Idromeno”, nr. pasurie 4/814, zona kadastrale 8593.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise :

Tregti me pakice dhe shumice te veshjeve dhe aksesoreve qe kane lidhje me to. Import-Eksport te veshjeve dhe aksesoreve qe kane lidhje me to. Objekti i shoqerise mund te ndryshohet, shtohet apo kufizohet ne baze te Vendimit te Asamblese .

Kohezgjatja Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat te papercaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar te Republikes se Shqiperise.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise është 100 lekë dhe është teresisht kapital financiar nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga ortaku i shoqerise perkatesisht:

CINZIA MUSU me 1 kuotë,

Me vendim te Asamblese se ortakeve kapitali mund te rritet sipas formave te parashikuara nga ligji.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve, deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Carlyle

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e ortakeve, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë mund të veprojë si përfaqësues i ortakut në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaku që përfaqëson të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqerise per periudhen e pare 5 vjecare , emerohet zj. **CINZIA MUSU**, lindur me 09.05.1978, ne Oristano (OR), Itali dhe banues ne Itali, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin **Nr.323187** dhe numer personal **CA13513CO** .

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorëve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortakëve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jete :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.
- b) Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare"
- c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.


Në këto raste Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë akt themelimi, statutin dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për



Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "OUTLET STORE " shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKU

CINZIA MUSU

